



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

---

Numri i lëndës: 2018:043913

Datë: 25.03.2019

Numri i dokumentit: 00256426

**P.nr.325/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore Prizren Dega në Suharekë Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Lavdim Bajraktari me procesmbajtësen Sherife Thaqi sekretare juridike e kësaj gjykate, në çështjen penale kundër të akuzuarit L. A., për veprën penale vjedhja e pyllit të parashikuar nga neni 358 parag.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren Departamenti i Përgjithshëm PP.II nr. 638/17 të datës 28.04.2017, në shqyrtimin fillestar të mbajtur datë 21.03.2019, në prani të Prokurorit të Shtetit Milot Krasniqi, dhe të akuzuarit L. A., mori dhe publikishtë shpalli, ndërsa me datë 22.03.2019 përpiloi ketë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari L. A. nga i ati Xh. dhe e ëma S. e gjinisë P., i lindur me 03.04.1992 në fshatin M. komuna Suharekë, ku edhe jeton, me numër personal ....., ka kryer shkollimin e fillor, i papunë, i martuar, i gjendjës së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse,**

Me datë 28.02.2017, rreth orës 13.40 minuta me qëllim të përvetësimit pasuror të kundërligjshëm në Suharekë, rrespektivishtë në vendin e quajtur "Sh. D.", njësia menagjuese "R." i akuzuari është hasur në dalje të pyllit i cili kishte prerë drunjë me sharrë motorrike të llojit Ahu me diametër mesatar prej 20 cm, me vëllimtë përgjithshëm 7.04 m<sup>3</sup> me çka të dëmtuarës Drejtoria për Planifikim, Zhvillim, Bujqësi dhe Pyllatri në Suharekë i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material.

**-me këto veprime ka kryer veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 358 parag.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)**

Gjykata në kuptim të neneve 7,17,21,41,43,46 49 par. 1 nën par. 1.1, 51, 73,74 358 par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), nenit 365, 450. 463 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK) të akuzuarin:

## **E G J Y K O N**

1. **ME KUSHT** me burgim në kohëzgjatje prej **4 (katër) muajve**, dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim mos të ekzekutohet nese i akuzuari në afatin e verifikimi prej **1 (një) viti** nuk kryen vepër tjetër penale nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit,
2. **ME DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **150 € (njëqind e pesëdhjetë euro)**, të cilin duhet të paguaj në afat prej 3 (tre) muajve pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe ate në tre këste të barabarta në fund të çdo muaji. Nese i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën gjykata mund të zavendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim llogaritet me 20 € (njëzet) Euro gjobë,
3. Obligohet t'i paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 € (njëzetë euro), dhe në emër të taksës për kompenzim të viktimave të krimit shumë prej 30 € (tridhjetë euro), të gjitha këto pas plotëfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyruar.
4. E dëmtuara Drejtoria për Planifikim, Zhvillim, Bijqësi dhe Pyllatri në Suharekë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP/II nr.638/17 të datës 28.04.2017, e ka akuzuar L. A., për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit të parshikuar me nenin 358 parag.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), aktakuzë të cilën e ka përfaqësuar prokurori i shtetit Milot Krasniqi, i cili fillimisht bëri përmirësimin e një gabimi të rrjedhur sa i përket tekstit në cilësimin e veprës penale ku është shënuar gabimisht shkatërrimi i pyejeve e që duhet të jetë vjedhje e pyllit, pjesa tjetër e akatakusës mbetet e pandryshuar.

Në shqyrtimin fillestar mbajtur me datën 20.03.2019, është lexuar aktakuza nga Prokurori i Shtetit dhe pas leximit të aktakuzës i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale me të cilën akuzohet duke deklaruar se pranoj fajsinë për veprën penale që akuzohem kërkoi nga gjykata që të i shqiptohet një dënim më i butë.

Prokurori i Shtetit lidhur me deklarinimin e të akuzuarit për pranimin e fajsisë, ka theksuar se nuk e kundërshton deklarinimin e të akuzuarit për ta pranuar fajsinë për veprën penale që i vihet në barrë, pranimi i fajsisë bëhet pa presion dhe në mbështetje në prova që përmban aktakuza dhe propozon që pranimi i fajsisë të merret si rrethanë lëhtësuese.

Gjyqtari vetëm gjykues pas deklarinimit të të akuzuarit dhe prokurorit të shtetit rreth pranimit të fajsisë ka marrë aktvendim me anë cilit ka pranuar deklarinimin e të akuzuarit për pranimin e fajsisë duke vlerësuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë

sipas nenit 248 të Kodit Procedures Penale te Republikës së Kosovës (KPPRK). Pastaj gjyqtari ka përcaktuar se i akuzuari kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, se pranimi bëhet vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajit mbështete në faktet e qështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke u bazuar në deklatimin e të akuzuarit për ta pranuar fajsinë në tërësi për të gjitha pikat e aktakuzës, gjykata nuk administroi me provat në këtë çështje penale juridike, pasi që gjykata ka vërtetuar këtë gjendje të pa kontestueshme faktike.

Se e datë 28.02.2017, rreth orës 13.40 minuta me qëllim të përvetësimit pasuror të kundëtlshëm në Suharekë, rrespektivisht në vendin e quajtur "Sh. D.", njësia menagjuese "R." i akuzuari është hasur në dalje të pyllit i cili kishte prerë drunjë me sharrë motorrike të llojit Ahu me diametër mesatar prej 20 cm, me vëllim të përgjithshëm 7.04 m<sup>3</sup> me çka të dëmtuarës Drejtoria për Planifikimin, Zhvillimin, Bujqësinë dhe Pyllatrin në Suharekë i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material.

Gjendjen e tillë faktike gjykata e ka vërtetuar nga vetë pranimi i fajsisë nga ana e të akuzuarit si dhe nga provat dhe faktet e pa kontestueshme që i përmban aktakuza, siç janë; kallzimi penal me nr 54/2017 i Drejtoria për Planifikimin, Zhvillimin, Bujqësinë dhe Pyllatrin në Suharekë, fletëparaqitja e rojtarit të pyllit me nr.14/2017.

Nga këto fakte dhe prova të vërtetuara në procedurë nga veprimet e të akuzuarit përmbushën të gjitha elementet e veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), të cilën e ka kryer me dashje direkte, duke përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme përfitim pasuror, duke i prerë drunjët të llojit Ahu në pyllin publik pa autorizim veprime këtë realizohen elementet e përgjithshme dhe të veçanta të figurës së kësaj vepre penale, ku të akuzuarit ju shqiptua sanksioni penal si në dispozitivin e këtij aktgjykimi..

Gjatë përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata për të akuzuarin pati parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73,74 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin muar faktin se e ka pranuar fajsinë në mënyrë shumë të sigurtë, se ndihet i penduar dhe i ka premtuar gjyqates se nuk do të përsërisë asnjëherë këtë vepër penale, i gjëndjes së vështirë materiale, mbajtës i familjës, i papunëusar, ka qenë bashkëpunues me gjykatën, ndërsa rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Për këtë vepër penale është paraparë dënimi me gjobë dhe burg prej 3 muajve deri në 3 vite, i akuzuari u gjykue me kusht me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, duke vlerësuar se tërheqja e vërejtjes me kërcnim të dënimit me burg është e nevojshëm që të ndaloj kryerjen të mos kryej vepra tjera penale, konform nenit 50 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) për qëllimin e dënimit me kusht, nese i akuzuari në afat prej një viti nuk kryen vepër tjetër penale, si dhe dënimin me gjobë prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro), me bindjen se këto dënime janë në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmerisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjesisë penale të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë që të parandaloi të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Vendimin mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në nenin 450 paragrafi 2 pika 2.6 dhe 3 të të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës ( KPPRK), ashtu që lartësia e paushallit gjyqësor në shumën prej 20 Euro u caktua duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmërinë e procedurës penale si dhe gjëndjen financiare të akuzuarit, ndërsa shumën prej 30 euro në emër të viktimave të krimit bazuar në nenin 39 paragrafi 3 të Ligjit mbi Kompenzimin e Viktimave të Krimit nr. 05/L-036.

Vendimin që të dëmtuarës lidhur me kërkesën pasurore juridike për kompenzimin e dëmit të shkaktuar me këtë vepër penale të udhëzoj në kontest civil, gjykata e bazoi në nenin 463 parag. 2 të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës (KPPRK), pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë të kësaj kërke.

Nga të lartcekurat është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2018:043913, 21.03.2019**

**G j y q t a r i**

---

Lavdim Bajraktari

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.